



Në bazë të nenit 3 të Programit për Financimin e Projekteve për Zhvillimin e Zejtarisë, Hotelarisë dhe Tregtisë së Qytetit të Shkupit për vitin 2022 ("Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 2/22), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE **për subvencionimin e zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare** **në shuarje në qytetin e Shkupit**

1. Lënda dhe qëllimi i Thirrjes publike është subvencionimi i zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare në shuarje në qytetin e Shkupit. Qyteti i Shkupit ka për qëllim nxitjen zhvillimin e zanateve tradicionale nëpërmjet subvencionimit të zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare në shuarje në qytetin e Shkupit, me subvencionim financiar me vlerë 10.000 denarë.

Në përputhje me Programin për Financimin e Projekteve për Zhvillimin e Zejtarisë, Hotelarisë dhe Tregtisë së Qytetit të Shkupit për vitin 2022 ("Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 2/22) nga Buxheti i Qytetit të Shkupit janë miratuar mjete në vlerë 500.000,00 denarë.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrje publike kanë:

- Zejtarët të cilët nuk kanë marrë mjete buxhetore nga projektet e subvencionimit nga Qyteti i Shkupit në vitin në vijim;
- Zejtarët të cilët janë të regjistruar sipas Ligjit për Zejtari ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 215/15 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 215/21) dhe kryejnë veprimtari zejtare në shuarje, të cilat sipas të dhënave të përpunuara shënojnë rënie të aktivitetit në vazhdimësi, përkatësisht zanatet e mëposhtme: jorganxhi, opingar, litarpunues, gëzofpunues, poçar, kapelapunues, farkëtar, teneqexhi, kopsar, qiribërës, sitëbërës, orëndreqës, punime zejtare-shporta, punime zejtare-përgatitje e suvenirëve, prodhime filigrani, bizhuteri dhe produkte të ngjashme, prodhim i instrumenteve muzikore dhe samarxhi).

3. Dokumente të nevojshme për aplikim:

- Kërkesë e plotësuar;
- Aktvendim për regjistrim në Regjistrin e Zejtarëve, leje zejtare;
- Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i RMV-së jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Detyrime të përmbushura ndaj Qytetit të Shkupit (taksa komunale – taksa për firmë dhe tatimi mbi pronën) nëse dyqani është në pronësi të aplikuesit. Kontrolli do të kryhet në rrugë zyrtare në Qytetin e Shkupit;
- Deklaratë nga aplikuesi se deri më tani nuk ka shfrytëzuar mjete nga Qyteti i Shkupit për asnjë nga qëllimet në vitin në vijim.

Dokumentacioni i lartpërmendur, i plotësuar plotësisht, depozitohet në origjinal ose kopje të noterizuar. Dokumentacioni i depozituar me vonesë, i paplotë nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e Komisionit.

4. Subvencionimi dhe shpenzime

- Aplikimet e zejtarëve do t'i shqyrtojë Komisioni për zbatimin e procedurës për subvencionimin e zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare në shuarje në qytetin e Shkupit, i themeluar nga kryetarja e Qytetit të Shkupit. Përzgjedhja e aplikuesve që plotësojnë kushtet e përcaktuara në Thirrjen Publike do të bëhet duke respektuar parimin "i pari i ardhur, i pari shërbehet", përkatësisht sipas renditjes së depozitimit të aplikimeve, deri në shterimin e mjeteve në dispozicion.
- Pas përzgjedhjes së aplikuesve, kryetarja e Qytetit të Shkupit do të lëshojë aktvendim me të cilin miratohet kërkesa për subvencionimin e zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare në shuarje në qytetin e Shkupit, me subvencionim monetar me vlerë 10.000 denarë.
- Një aplikues mund të shfrytëzojë subvencion vetëm njëherë për Thirrjen publike të shpallur në vitin në vijim.

- Thirrja publike është shpallur në ueb-faqen www.skopje.gov.mk

5. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimit

Depozitimi i aplikimit në formë letre

Aplikimi për subvencionimin e zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare në shuarje në qytetin e Shkupit me dokumentacionin e plotë duhet të depozitohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënimin – Aplikim për Thirrjen publike për subvencionimin e zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare në shuarje në qytetin e Shkupit), **më së voni deri më 10.12.2022.**

Nëse mjetet e planifikuara financiare janë shteruar, Qyteti i Shkupit do të shpallë përfundimin e Thirrjes publike nëpërmjet ueb-faqes së tij.

Pagesa e mjeteve të miratuara do të bëhet në mënyrë sukcesive, sipas renditjes së aplikimeve të pranuar sipas parimit "I pari i ardhur, i pari shërbehet", në bazë të aktvendimit për miratim nga kryetarja e Qytetit të Shkupit. Në rast mospranimi të kërkesës, aplikuesi njoftohet me shkrim.

Aplikimet për subvencionimin e zanateve të vjetra dhe veprimtarive zejtare në shuarje në qytetin e Shkupit janë në dispozicion në Arkivin e Qytetit të Shkupit, Seksioni për mbështetjen e zhvillimit të zejtarisë dhe tregtisë dhe në ueb-faqen www.skopje.gov.mk.

Pyetje për sqarime plotësuese mund të depozitohen me shkrim ose nëpërmjet rrugës elektronike pranë Sektorit për Zhvillim Lokal Ekonomik.

Telefoni kontaktues: (02) 3297-372 dhe 3297-328, adresa e-mail: Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk

QYTETI I SHKUPIT